



K.R.U "Hidroregjioni Jugor" SH.A., Rr. Wesley Clark,  
Pn. 20000, në Prizren

01-15/01  
23.12.2016  
PRIZREN

Në bazë të Nenit 7, pika 2 të Statutit të K.R.U."Hidroregjioni Jugor"Sh.A., me datë 23.12.2016,  
Bordi i Drejtorëve të K.R.U."Hidroregjioni Jugor"Sh.A., me seli në Prizren, aprovoi këtë

## **RREGULLORE PËR UDHËTIMET ZYRTARE NË KRU"HIÐROREGJIONI JUGOR"SH.A,PRIZREN**

### **Neni 1 Qëllimi**

Kjo Rregullore përcakton procedurat për udhëtimet zyrtare si dhe mëditjet për këto udhëtime, për të siguruar përdorimin ekonomik dhe efikas të mjeteve financiare të KRU"Hidroregjioni Jugor"sh.a-Prizren.

### **Neni 2 Udhëtimet zyrtare**

1. Udhëtime zyrtare janë lëvizjet të cilat kanë destinacion apo qëllim i cili shërben për kryerjen e detyrave zyrtare në interes të KRU"Hidroregjioni Jugor"Sh.a.
2. Zyrtaret e KRU"Hidroregjioni Jugor", mund të kenë udhëtime zyrtare si pjesëmarrës në:
  - 2.1 delegacione;
  - 2.2 konferenca;
  - 2.3 seminare;
  - 2.4 veprimtari të ndryshme ndërkombëtare;
  - 2.5 marrjen dhe zhvillimin e njohurive nga ofrues ndërkombëtar.
  - 2.6 panaire etj.

### **Neni 3**

#### **Procedurat për realizimin e udhëtimeve zyrtare**

1. Kërkesa për udhëtime zyrtare duhet të dorëzohet së paku pesë ditë punë para shkuarjes në udhëtim zyrtar, përveç rasteve të jashtëzakonshme.
2. Për çdo udhëtim zyrtar duhet zbatuar këto procedura:
  - 2.1 të plotësojnë Formularin e kërkesës për udhëtime zyrtare (shtojcën 1) të cilit do ti bashkëngjitet arsyetimi me shkrim, si dhe lista zyrtare e institucionit dhe agjenda e takimit zyrtar.
  - 2.2 pas plotësimit të formularit të kërkesës për udhëtim zyrtar (shtojca 1), nga zyrtari i cili udhëton, dhe pas miratimit të saj nga menagjeri i tij/saj, kërkesa merr miratim përfundimtar nga KE i KRU "Hidroregjionit Jugor" dhe si e tillë kërkesa e miratuar i dorëzohet shërbimit të personelit.
  - 2.3 Kërkesa duhet të përmbajë edhe mjete financiare, të cilat duhet të arsyetohen dhe pastaj të sillen dëshmi të duhura për shpenzimet e mjeteve financiare.
  - 2.4 Formulari i miratuar i kërkesës për udhëtim zyrtar duhet t'i dorëzohet shërbimit për buxhet dhe financa.

### **Neni 4**

1. Asnjë udhëtim zyrtar nuk mund të realizohet pa kërkesë paraprake të miratuar sipas nenit 3, pika 2.2 të kësaj Rregulloreje.
2. Në rastet e udhëtimit të Kryeshefit kërkesa duhet miratuar nga Bordi para udhëtimit.
3. Në rast udhëtimit të anëtarëve të Bordit, kërkesa duhet miratuar nga Njësia për Politikë dhe Monitorim të Ndermarrjeve Publike së paku pesë ditë para udhëtimit.

### **Neni 5**

#### **Kompensimi**

1. Kërkesa për kompensim dhe për mëditjen së bashku me të gjitha të dhënat për shpenzimet financiare për udhëtim zyrtar, i dorëzohet shërbimit për buxhet dhe financa brenda afatit 15 ditësh pune nga dita e përfundimit të udhëtimit zyrtar. Në rast të mospërfilljes së këtij afati, kërkesa e tillë refuzohet.
2. Nëse udhëtimi zyrtar përmban implikime financiare ato shënohen në formularin e kërkesës për udhëtim zyrtar. Arsyetimi i mjeteve financiare bëhet në faturat e sjella pas udhëtimit zyrtar të cilat dorëzohen në shërbimin për buxhet dhe financa të KRU "Hidroregjionit Jugor" së bashku me shkresën përcjellëse përkatëse.

3. Pagesa për ditët e udhëtimit zyrtar fillon në ditën e nisjes dhe përfundon në ditën e kthimit.

#### **Neni 6** **Mëditjet**

Shuma e mëditjeve paguhet sipas tarifave të përcaktuara nga Ministria e Financave.

#### **Neni 7**

Kur shpenzimet janë në ngarkim tërësisht të palës pritëse, të cilat u sigurojnë personave vetëm shpenzimet e ushqimit dhe të fjetjes pa u paguar asgjë në dore, këta persona përfitojnë nga buxheti i Kompanisë shpenzime të vogla-para gjepi, të përcaktuara në shumën prej 20% të mëditjes sipas tarifave të përcaktuara nga Ministria e Financave në ditë si dhe shpenzimet e tjera të vendosjes apo të ushqimit të cilat nuk paguhen nga pala pritëse.

#### **Neni 8**

Kur shpenzimet janë në ngarkim tërësisht të palës pritëse, të cilat u sigurojnë personave, shpenzimet e ushqimit dhe të fjetjes duke u paguar edhe shpenzime të vogla para-xhepi në dorë atëherë këta persona nuk përfitojnë para të gatshme nga buxheti i KRU "Hidroregjionit Jugor".

#### **Neni 9**

1. Klasa e lejuar për udhëtime zyrtare me aeroplan është klasa ekonomike. Nëse planet e udhëtimit ndryshojnë pasi të jetë marrë bileta, atëherë institucioni përkatës do të marrë përgjegjësin për çdo shpenzim shtesë.

2. Nëse udhëtimi është me ekonomik sesa ai i miratuar, shuma e cila do të paguhet do të jetë e kufizuar në shumën më të vogël.

#### **Neni 10**

Kur një zyrtar udhëton sipas një rruge alternative apo në një mënyrë tjetër transporti, maksimumi i lejuar i shpenzimeve të udhëtimit do të llogaritet duke u bazuar në tarifën me ekonomike të një rruge të drejtpërdrejt.

#### **Neni 11**

1. Zyrtari para udhëtimit zyrtar ka të drejtë të marrë paradhënie paraprake për udhëtim zyrtar.

2. Huat paraprake-paradhëniet për udhëtim zyrtar, nëse e tejkalojnë shumën e shpenzimeve, duhet të kompozohen përmes sistemit bankar të pagesave. Huat paraprake-paradhëniet për udhëtime zyrtare nëse nuk e tejkalojnë shumën e shpenzimeve të cilat duhet të kompozohen, do

të rimerren përmes sistemit bankar të pagesave. Nëse zyrtari nuk e kthen atë shumë, atëherë ajo shumë merret përmes sistemit të pagave (Payroll-it).

### **Neni 12**

1. Te gjitha shpenzimet gjatë udhëtimeve zyrtare si shpenzimet e fjetjes, te transportit dhe shpenzimet e tjera në ngarkim te institucionit përkatës, për te gjitha rastet, mbulohen sipas dokumentit përkatës ( faturës, biletës. etj.).

2. Paga për shpenzimet e udhëtimit dhe te mëditjeve do te behet në Euro.

### **Neni 13**

Kur konstatohen keqpërdorime te mjeteve financiare, do të informohet Kryeshefi i KRU" Hidroregjionit Jugor" nga organet përgjegjëse, i cili do te ndërmarr te gjitha masat përkatëse kundër personit i cili ka keqpërdor mjetet.

### **Neni 14**

Përgjegjësinë për zbatimin e kësaj Rregullore e ka Kryeshefi Ekzekutiv i KRU" Hidroregjioni Jugor" sh.a-Prizren.

### **Neni 15**

#### **Hyrja në fuqi**

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Bordi i Drejtorëve të K.R.U" Hidroregjioni Jugor" SH. A. – Prizren..

Datë : 23.12.2016  
Prizren

K.R.U. " Hidroregjioni Jugor" SH. A. – Prizren  
Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve

  
Rexhep Manxhuka

